



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:160971

Datë: 26.03.2025

Numri i dokumentit: 07050091

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.223/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me zyrtaren ligjore Artta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.U nga Vushtrria, për shkak të veprës penale *Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale* nga neni 333 par. 2 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1957/21 të datës 26.07.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 20.03.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit Shaqir Sedolli dhe të pandehurit B.U, në të njëjtën datë shpalli, ndërsa me datë 26.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri: B.U, nga i ati B..., e ëma S..., e vajzërisë K..., i lindur më ..., me vendbanim në Vushtrri, rr. "...” nr..., me numër personal ..., të kryer shkollën e mesme, i vetëpunësuar në servisim- shitblerje të telefonave në mobil shop "...”, i martuar, prind i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

SHPALLET FAJTOR

I. SEPSE: Gjatë muajit gusht të vitit 2021, në rrugën "...”, në Vushtrri, saktësisht në lokalin e tij mobi shop "...”, i pandehuri blen telefonin e markës Iphone 11 pro, ngjyrë vjollce, 64 GB, me numër të IMEI 356814111957373, në shumën prej 60-70 euro, i cili ishte përfituar me kryerjen e veprës penale *Vjedhja*, për të cilat në bazë të çmimit i pandehuri ka mundur të dijë se është përfituar me kryerjen e veprës penale.

Me këtë ka kryer veprën penale ‘*Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale*’ nga neni 333 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 par. 1, nën par. 1.7, të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 450 të KPPK-së,

E G J Y K O N

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 200€ (dyqind euro), i cili dënim duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri refuzon të paguaj dënimin me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

II. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

III. Pala e dëmtuar V.C për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.1957/21 të datës 26.07.2023 kundër të pandehurit B.U nga Vushtrria, për shkak të veprës penale *Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale*’ nga neni 333 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 20.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Shaqir Sedolli dhe i pandehuri B.U.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe sqarimit të benefiteve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri ka deklaruar se ndjehet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, është penduar që e ka kryer këtë vepër, si dhe ka shtuar se i premtton gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe se është mbajtës i familjes.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje dispozitat e KPPRK-së për institutin e pranimit të fajësisë, i njëjti mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, është bërë në mënyrë vullnetare dhe i pandehuri i kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë dhe gjykatës i ka propozuar që pranimin e fajësisë ta aprovojë. Andaj, nëse gjykata e aprovon pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit, përcaktimit të llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ashtu që si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, po ashtu prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale dhe nëse nga ajo rezulton se i pandehuri është i dënuar edhe më parë ta merr si rrethanë rënduese dhe e kundërta nëse nuk është dënuar më parë, ta merr parasysh se rrethanë lehtësuese.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Procesverbali për marrjen në pyetje të dëmtuarit – dëshmitarit V.C në SP Vushtrri, i datës 08.08.2021; Procesverbali për marrjen në pyetje të dëshmitarit B.T në SP Vushtrri, i datës 08.08.2021; Procesverbali për marrjen në pyetje të dëshmitarit B.H në SP

Vushtrri, i datës 08.08.2021; Raporti i oficerit A.G #1833, me numër 2021-BD-686, i datës 08.08.2021; Dy fotografi ku shihen të dhënat e telefonit dhe tri fotografi ku shihet telefoni në gjendjen që është gjendur; Përgjigja nga IPKO, e datës 16.09.2021; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, me numër 2021-BD-686, i datës 04.11.2021; Vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht, me numër 2021-BD-686, i datës 04.11.2021; Informacionet për të kaluarën e të pandehurit B.U të marra nga baza e Policisë së Kosovës, si dhe Procesverbali për intervistimin e të pandehurit B.U në SP Vushtrri, i datës 19.10.2021, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Për veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par. 2 të KPRK-së, ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me burgim deri në një (1) vit, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuarit vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë në shumë prej dyqind (200) euro, të cilin dënim është obliguar i pandehuri që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese për të pandehurin ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore, ndërsa në kuadër të rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj veprë penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, më parë i pa gjykuar.

Ashtu që gjykata, pasi i ka vlerësuar rrethanat lehtësues, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 71 par. 1 nën par. 1.3, të KPRK-së, për zbutur dënimin me burgim, dhe me këtë rast gjykata duke zbatuar nenin 72 par 1 nën par 1.7, ku përcaktohet se *“nëse për veprën penale nuk është paraparë masa më e ulët e dënimit, atëherë mund të shqiptohet dënimi me gjobë në vend të dënimit me burgim”*, andaj gjykata pasi që gjeti rrethanat lehtësuese të përshkuara si më lartë, zbuti dënimin e të pandehurit për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është paraparë shqiptimi i dënimit me burgim deri në 1 vit, e meqenëse nuk është paraparë minimumi i dënimit me burgim, gjykata në kuptim të dispozitës së cituar, dhe pas vlerësimit të të gjitha rrethanave, gjeti se në rastin konkret mund të zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit, e që në këtë kuptim të pandehurit i shqiptoj dënim me gjobë në shumën prej 200€ (dyqind euro).

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se në rastin konkret, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bien në kundërshtim me ligjin, t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.223/2023, datë 26.03.2025

Zyrtarja Ligjore

Arta Jusufi

G j y q t a r i

Naim Rekalio

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.